

Fjalë drejtuar baballarëve (6:4)

Gjatë viteve 1800 në SHBA, shumë familje lanë shtëpitë e tyre, në zonat e mbi-populluara në lindje të vendit, dhe filluan të zhvendoseshin për në perëndim, ku kishte toka të lira me bollëk. Pas mbërritjes në tokën e re, ata vazhduan të lëviznin, në kërkim të tokave të lira, të pazëna nga ata që kishin ardhur më parë. Zakonisht, këto familje udhëtonin së bashku në karroca. Çdo karro kishte një zbulues. Ai shkonte dy ditë përpara nisjes së karrocës për të parë nëse rruga që do të përshkonin ishte e sigurtë. Ai shikonte se mos kishte indianë, shikonte të gjente vende të sigurta për të kaluar lumenjtë. Ai shikonte qiellin se mos kishte ndonjë shenjë për stuhi. Zbuluesi i çdo karroce kishte për detyrë të ruante për rreziqet që mund të ndodhnin, të shikonte se mos kishte armiq rrugës dhe të zgjidhte rrugën më të sigurt për karrocën.

Në një farë mënyre, etërit në çdo familje kanë të njëjtën detyrë që kishte zbuluesi i karrocës. Një at e udhëheq familjen në udhëtimin e saj nëpër jetë, duke drejtuar gruan e tij dhe duke i përgatitur fëmijët e tij çdo ditë të drejtojnë jetën e tyre, kur të vijë koha. Detyra e tij është që të drejtojë të gjithë familjen drejt Perëndisë.

Përfytyroni një familje që udhëton në një karro. Rruga është plot rreziqe. Rreth e rrotull ka armiq që janë gati të sulmojnë. E gjithë familja pret që ati t'i ruajë dhe t'i drejtojë. Ata presin që ai t'u tregojë rrugën. Ata presin që ai t'i ruajë nga të gjitha rreziqet.

Pali foli për rolin drejtues të etërve të Efesianëve 6:4: «Dhe ju, etër, mos provokoni për zemërim fëmijët tuaj, por i edukoni në disiplinë dhe në këshillë të Zotit.» E vërteta themelore e këtij vargu është kjo: *Perëndia u bën thirrje etërve që të drejtojnë me perëndishmëri familjet e tyre.*

Etërit punojnë shumë që familja e tyre të ketë një çati mbi kokë dhe ushqim në tavolinë, *por nuk është kjo detyra e tyre kryesore!* Ajo për të cilën ata paguhen çdo 15 ditësh nuk është detyra e tyre kryesore. *Detyra e tyre kryesore është familja e tyre!* Perëndia u ka dhënë një detyrë për të udhëhequr familjen e tyre. Perëndia pret që etërit të drejtojnë familjen në rrugën plot rreziqe dhe ta çojë atë në destinacionin që Ai ka përgatitur për ta. Çfarë njohurie na jep Fjala e Perëndisë për ta kryer këtë detyrë? Pali u tregon etërve ç'duhet të bëjnë dhe çfarë nuk duhet të bëjnë në vargun 4.

MOS PROVOKONI FËMIJËT TUAJ

Pali tha: «Dhe ju, etër, mos provokoni për zemërim fëmijët tuaj» (6:4a). Fjala «provokoj» do të thotë «të nxitësh për zemërim, të shkaktosh zemërim e hidhërim». Do të thotë të provokosh fëmijët për zemërim deri në atë pikë ku ata ziejnë nga zemërimi. Kur kjo ndodh, fëmijët nuk i dëgjojnë më etërit e tyre dhe nuk ecin më në rrugën që ata u tregojnë. Shumë të këqija vijnë kur njerëzit nuk ndjekin drejtuesin që u ka caktuar Perëndia. Cilat janë disa nga mënyrat që mund t'i bëjnë fëmijët të

ziejnë nga zemërimi?

1. *Tutela e tepruar.* Mund t'i mbytim fëmijët. Kjo ndodh kur nuk i lejojmë kurrë që të provojnë aventurat e tyre. Mund t'i ruajmë kaq shumë sa që ata nuk do të kenë kurrë ndonjë liri dhe nuk do të mësojnë kurrë të jenë të pavarur.

2. *Anësia.* Tregojmë anësi kur nuk kujdesemi dhe interesohemi njësoj për të gjithë fëmijët në familje. Lexoni historinë e Jozefit, atit dhe vëllezërve të tij. Vini re vështirësitë e tyre si pasojë e anësisë.

3. *Dekurajimi.* Një fëmijë nuk duhet të dëgjojë kurrë nga ati i tij fjalë të tilla si: «Kurrë nuk do të bëhesh i vlefshëm» apo «Nuk mund të bësh asgjë si duhet».

4. *Përpjekja për t'i bërë gjithë fëmijët njësoj.* Etërit nuk duhet të përpiqen që t'i bëjnë të gjithë fëmijët njësoj. Nuk duhet të përpiqemi t'i formojmë fëmijët sipas një modeli që kemi në mendje. Fëmijët kanë nevojë të shprehin veçantinë e tyre.

5. *Neglizhimi.* Robert Kols e kishte mirë kur shkroi:

Mendoj se ajo që u duhet fëmijëve amerikanë është një qëllim për jetën. Ata kanë prindër të cilët janë shumë të shqetësuar për t'i futur në kolegjet më të mira, për t'u blerë rrobat më të modës, për t'u dhënë mundësinë të jetojnë në qytete ku mund të jetojnë jetë të qetë e të mirë dhe ku mund të luajnë me lodrat më të mira, të kalojnë pushimet më fantastike dhe të tjera gjëra si këto.... Prindërit punojnë shumë në ditët tona. Ata arrijnë gjëra që mendojnë se janë të rëndësishme për fëmijët e tyre. Por, prapë se prapë, nuk arrijnë të kryejnë gjërat më të rëndësishme. *Ata nuk kalojnë kohë të mjaftueshme me fëmijët e tyre.*

6. *Egërsia.* Prindërit nuk kanë të drejtë të jenë të egër apo të shfryjnë zemërimin dhe hidhërimin e tyre mbi fëmijët. Shumica e atyre që i keqtrajtojnë fëmijët e tyre kanë qenë të keqtrajtuar në fëmijërinë e tyre, por një at kristian nuk duhet të lejojë që një cikël i tillë të vazhdojë.

Në librin e tij: «*Dhjetë gabimet që prindërit bëjnë ndaj adoleshentëve*», Xhei Kesler flet për disa gabime që etërit mund të bëjnë, të cilat çojnë në zemërim dhe si rezultat dëmtojnë marrëdhënien prind-fëmijë. Kam dy fëmijë adoleshentë dhe e pranoj se i kam bërë pothuajse të gjitha gabimet e mëposhtme.

Gabimi nr. 1 – Dështimi për të qenë një shembull i qëndrueshëm. «Bëj si them unë, mos bëj si bëj unë.»

Gabimi nr. 2 – Dështimi për të pranuar se je gabim. «Unë jam i madhi. Unë kam të drejtë.»

Gabimi nr. 3 – Dështimi për të dhënë përgjigje të

sinqerta për pyetjet e sinqerta. «Sepse kështu them unë, ja pse.»

Gabimi nr. 4 – Dështimi për të lejuar adoleshentin të zhvillojë identitetin e tij vetjak. «Çfarë do të bëhesh, the?»

Gabimi nr. 5 – Dështimi për t'u përqëndruar në më të rëndësishmet. «Kjo dhomë është si stallë derrash.»

Gabimi nr. 6 – Dështimi për të treguar miratim dhe pranim. «A ka gjë që di ta bësh si duhet?»

Gabimi nr. 7 – Dështimi për të pranuar shokët e fëmijës tuaj adoleshent pa bërë fare përpjekje për t'i njohur ata. «Ku e gjetë atë?»

Gabimi nr. 8 – Dështimi për t'i dhënë adoleshentit të drejtën për të gabuar. «Ç'bërë kështu more?!!»

Gabimi nr. 9 – Dështimi për të biseduar për gjëra që të vënë në siklet. «A mund të flasim për diçka tjetër?»

Gabimi nr. 10 – Dështimi për të pasur kohë. «Jam i zënë tani. Eja më vonë.»

Perëndia u bën thirrje etërve që të evitojnë veprimet të cilat tregojnë anësi dhe provokojnë zemërim te fëmijët. Fëmijët e mi më thonë nganjëherë: «Nuk po tregohesh i drejtë.» Nganjëherë kanë të drejtë. Nganjëherë nuk jam i drejtë. Perëndia pret më shumë prej meje dhe prej të gjithë etërve në këtë botë.

DREJTONI FËMIJËT TUAJ

Përfytyroni për një moment një stol me tre këmbë. Në qoftë se hiqni njërin këmbë, stoli nuk do të jetë në gjendje të qëndrojë. Pali përmendi tre elemente për drejtimin e fëmijëve. Të tre këto elemente janë të domosdoshme që etërit t'i drejtojnë fëmijët me sukses.

1. *Përkujdesje.* Kjo ide gjendet në shprehjen: «rrit fëmijët». Fjalë për fjalë kjo do të thotë: «të ushqesh, të edukosh apo të rritësh me kujdes». Etërit e perëndishëm janë burra që përkujdesen. Alan Loi Mekginis tha: «Marrëdhëniet ndërtohen, ashtu si dhe llakimi, me shtresat e përkujdesjes.»

Etër, që të drejtoni fëmijët, duhet të jeni plot përkujdesje e butësi. Si mund të mësojmë të jemi të kujdesshëm e të butë?

(a) Dëgjojin fëmijët dhe u bëni të njohur se i respektoni ndjenjat e tyre.

(b) Kërkojuni të falur kur e keni gabim apo keni qenë shumë të egër me ta.

(c) Mos i kurseni përqaftimet dhe përkëdheljet për ta.

(d) Inkurajojini fëmijët tuaj në përpjekjet e tyre.

(e) Dëgjoni se çfarë ju thotë bashkëshortja për mënyrën se si e trajtoni secilin fëmijë.

Perëndia na bën thirrje që të jemi drejtues të

mirë e të butë, gjë që nuk është e pahijshme për burrin. Burrat janë ashtu si do Perëndia kur tregohen të butë me fëmijët e tyre.

2. *Disiplinë.* Etërit duhet t'i edukojnë fëmijët në «disiplinën» dhe në «këshillën» e Zotit. Kjo do të thotë «të edukosh duke pasur rregulla, shpërblime dhe ndëshkime po të jetë e nevojshme». Luka e përdori këtë fjalë për të treguar se çfarë tha Pilati për Jezusin: «Prandaj, pasi ta fshikullojnë, do ta lëshoj» (Luka 23:16). Te Hebrenjve 12:11 thuhet: «Çdo ndreqje, pra, aty për aty, nuk duket se sjell gëzim, po hidhërim; por më pas u jep një fryt drejtësie atyre që janë ushtruar me anë të tij.»

Xhejms Dobson e përshkroi disiplinën si formimin e vullnetit. Disa nga sugjerimet e tij për këtë janë:

(a) *Përcaktoni kufijtë para se t'u kërkonit fëmijëve t'i respektojnë ata.* Fëmija duhet të dijë që më parë se çfarë është e pranueshme para se të jetë përgjegjës për të.

(b) *Kur fëmija ju sfidon me mospërfillje, përgjigjuni me vendosmëri të sigurt.* Kur ka mosmarrëveshje midis prindërve dhe fëmijës, prindërit duhet të «fitojnë» me vendosmëri dhe siguri.

(c) *Bëni dallimin midis mosbindjes së vullnetshme dhe mosbindjes fëmijërore.* Fëmija nuk duhet rrahur me shuplakë në qoftë se harron të derdhë plehrat apo se derdh pa dashje gotën e qumështit. Mosbindja e kryer me dëshirë është çështje tjetër me të cilën duhet të merreni në mënyrë direkte.

(d) *Pas «konfliktit» i mësoni dhe i sqaroni fëmijët.*

(e) *Evitoni kërkesat e pamundshme.* Mos i ndëshkoni fëmijët në qoftë se nuk arrijnë të bëjnë

dot menjëherë atë që ju kërkon.

(f) *Lëreni dashurinë t'ju drejtojë.*

Dy nga këmbët e një stoli me tre këmbë për etërit janë butësia (përkujdesja) dhe disiplina. Kjo na sjell te «këmbe» e tretë.

3. *Këshillimi.* Fjala «këshillim» do të thotë «të mbash parasysht». Kjo fjalë i referohet udhëzimit apo paralajmërimit gojor. Prifti Eli nuk arriti ta bënte këtë me djemtë e tij. Vini re se çfarë ndodhi:

Atëherë Zoti i tha Samuelit: «Ja, jam duke bërë në Izrael një gjë që do të shungullojë veshët e kujt do ka për ta dëgjuar. Atë ditë unë do të kryej kundër Eliut të gjitha ato që thashë lidhur me shtëpinë e tij, nga fillimi deri në fund. Po i deklaroj që jam bërë gati të ndëshkoj shtëpinë e tij për gjithnjë, për shkak të paudhësisë që e karakterizon, sepse bijtë e tij janë bërë të neveritshëm dhe ai nuk i ka frenuar (1 Samuelit 3:11–13).

Në gjuhën origjinale hebraike, fjala që këtu është përkthyer «frenuar» do të thotë «këshilluar». Eli e kaloi jetën duke i shërbyer Perëndisë. Ai udhëhoqi shërbimin e adhurimit të Izraelit, por nuk i frenoi (këshilloi) bijtë e tij kur kishin nevojë për një gjë të tillë. Nganjëherë etërit duhet të jenë të prerë me fëmijët e tyre. Këshillat e drejtpërdrejta e të prera janë të domosdoshme për rritjen si duhet të fëmijëve.

KONKLUZION

Perëndia i jep çdo ati përgjegjësinë për të drejtuar familjen e tij nëpërmes rreziqeve, vështirësive dhe sfidave të jetës. Drejtojeni familjen në një mënyrë të tillë që nuk do të provokojë fëmijët tuaj për zemërim. Drejtoni duke përdorur butësinë (përkujdesjen), disiplinën dhe këshillimin.

Autor: *Rusty Peterman*
Marrë nga seria: *“Efesianëve”*
© 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara